



BASHKIA  
TIRANË

**Drejtuar:** Shoqëria “SAG” shpk  
Adresa: Asim Zeneli, Pallati SAG, Kati II

**TIRANE**

## **FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Procedura e prokurimit: **“Ndërtim i ambjenteve sportive në shkollën e mesme Verri”**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Ndërtim i ambjenteve sportive në shkollën e mesme Verri”** duke realizuar, punimet për ndërtimin e ambjenteve sportive në shkollën e mesme Verri, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit

Fondi limit: **8.183.310** (tetë milion e njëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e dhjetë) lekë pa TVSH

Burimi i financimit: Të ardhura – vënë në dispozicion në Zbatim të Vendimit Nr.58 datë 30.12.2015 për “Miratimin e programit buxhetor afat mesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **datë 12.12.2016 , ora 11:00**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: **Buletini i Njoftimeve Publike datë 05.12.2016**

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. “FLONJA” shpk me NUIS J 71826003 M**

Vlera e ofertës pa TVSH 5.276.691 (pesë milion e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një) lekë

**2. “ELIRA” shpk me NUIS J 63423410 S**

Vlera e ofertës pa TVSH 5.803.029 (pesë milion e tetëqind e tre mijë e njëzetë e nëntë) lekë

**3. “AVDULI” shpk me NUIS J66703306O**

Vlera e ofertës pa TVSH **7.174.519** (shtatë milion e njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e pesëqind e nëntëmbëdhjetë ) lekë

**4. “S.AG” shpk me NUIS K51802003 G**

Vlera e ofertës pa TVSH 6.233.472 (gjashtëmilion e dyqind e tridhjetë e tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy) lekë

**5. LEON CONSTRUCTION me NUIS K71820009 I**

Vlera e ofertës pa TVSH 6.766.336,09 (gjashtë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë lek e treqind e tridhjetë e gjashtë presje zero nëntë) lekë

**6. BOSHNJAKU B me NUIS K72627402 H**

Vlera e ofertës pa TVSH 7.929.669 (shtatë milion e nëntëqind e njëzetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë

**7. SIRETA 2F me NUIS K51501008 J**

Vlera e ofertës pa TVSH 0 (zero) lekë

**8. LIQENI VII me NUIS K01730502W**

Vlera e ofertës pa TVSH 7.738.028 (shtatë milion e shtatëqind e tridhjetë e tetë mijë e njëzetë e tetë ) lekë

Janë skualifikur ofertuesit e mëposhtëm:

**1.Operatori Ekonomik “SIRETA 2F ” shpk**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

**1. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “SIRETA 2F ” shpk me vlerë të ofertës 0 ( zero) lekë pa TVSH**

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “**SIRETA 2F**” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike sipas Shtojcës 1, të dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “**SIRETA 2F**” Sh.p.k s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, shtojca 9,e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**2. Operatori Ekonomik “LEON CONSTRUCTION” shpk**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

***Në dokumentat standartë të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik në pikën 11 citohet si më poshtë:***

*11.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 8).*

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
<i>Kamiona veteshkarkues (kapaciteti total mbajtës minimumi 10 ton pra 5 ton secili)</i>	<i>Minimumi 2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Eskavator me goma</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autobetoniere</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kamioncine</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autobot uji</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Skeleri</i>	<i>50 m<sup>2</sup></i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autovinç me kosh</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>vinç</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Pompë betoni</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Moto gjenerator</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Fadromë</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Betoniere</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Pompë suvatimi</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të jera duhet të jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata perkatese noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- f) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).*
- g) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin*

e mjetit (te vlefshme), dhe per mjetet e siguruara me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

**Operatori ekonomik “LEON CONSTRUACION”shpk ka deklaruar në shtojcën 8 eskavator me goma me targë ABY 212, me faturë përkatëse. Për eskavatorin me goma shoqëria nuk ka paraqitur dokumentacionin shoqërues (targat e mjeteve, lejë qarkullim, certifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit) C’ka bie në kundërshtim me “Kriteret e veçanta për kualifikim”, kapaciteti Teknik pika 11, gërma (a) ku citohet:**

**Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (lejë qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi**

Pra sa më sipër cituar lidhur me eskavatorët me goma nuk ka dokumentacionin e nevojshëm. Gjithashtu shoqëria “LEON CONSTRUCTION” shpk, ka deklaruar në shtojcën 8 Autovinç me kosh copë 1 me targë TR 2938 P, Fadromë copë 1 me targë AA904 JA me kontratë qeraje nr.4502 rep, nr 1622 kol dhe Autobetonierë Aao66LN me kontratë qeraje me nr.570 rep dhe nr.216 kol, ajo cka komisioni vuri re është se për mjetet e mësipërme të deklaruara shoqëria nuk ka paraqitur foto ashtu edhe siç kërkohet në pikën 11/d tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik.

Për sa më sipër dokumentacioni I paraqitur nga shoqëria “LEON CONSTRUCTION” shpk lidhur me mjetet e mësipërme është I paplotë

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

### **3. Operatori Ekonomik “LIQENI VII” shpk**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

***Në dokumentat standartë të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti***

**Teknik në pikën 5 dhe 6 citohet si më poshtë:**

5.Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë pjesë të stafit teknik të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, dhe **të figurojnë në listpagesat e shoqërisë:**

Inxhinier Ndërtimi (1)

**Inxhinier Mjedisi (1)**

Elektrik (1)

Inxhinier Mekanik (1)

6.Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në stafin teknik, punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me te si me poshte:

**Saldator (1)**

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me të, **si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 6 (gjashtë) muajt e fundit.**

Operatori ekonomik “LIQENI VII” shpk ka deklaruar si inxhinier mjedisi Z. Neritan Ciplaku dhe si saldator Z.Lutfi Kurti të cilët nuk figurojnë në listë pagesën e muajit Korrik 2016, sic edhe kërkohet në dokumentat standarte të tenderit më saktë në pikën 5 dhe 6 të **Kritereve e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik**

*Për sa më sipër dokumentacioni I shoqërisë lidhur me pikën 5 dhe 6 është I paplotë.*

**Në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik në pikën 11 citohet si më poshtë:**

*11.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 8).*

Mjetet	Sasia	Gjendja
<b>Kamiona veteshkarkues (kapaciteti total mbajtës minimumi 10 ton pra 5 ton secili)</b>	<b>Minimumi 2 copë</b>	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamioncine	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Skeleri	50 m <sup>2</sup>	Pronësi ose me qera
Autovinç me kosh	1 copë	Pronësi ose me qera
vinç	1 copë	Pronësi ose me qera
Pompë betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Moto gjenerator	1 copë	Pronësi ose me qera
<b>Fadromë</b>	1 copë	Pronësi ose me qera
Betoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Pompë suvatimi	1 copë	Pronësi ose me qera

*h) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe per mjetet e siguruara me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te jera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.*

*i) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që*



vërtetojnë pronësinë e tyre.

- j) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- k) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- l) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- m) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi).
- n) Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) duhet të shoqerohet me kontratën përkatëse të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jone aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

Operatori ekonomik "LIQENI VII" shpk ka deklaruar në shtojcën 8 1 Kamion Vetëshkarkues me targë DR0532 E ndërkohë që në dokumentat e tenderit në pikën 11 kërkohet të paraqiten dy kamiona vetëshkarkues (kapaciteti total mbajtës minimumi 10 ton pra 5 ton secili) , gjithashtu në pikën 11 kërkohet të paraqitet për ekzekutimin e kontratës Autovinç me Kosh Pra sa më sipër cituar lidhur me kamionat vetëshkarkues dhe autovinçi me kosh nuk ka dokumentacionin e nevojshëm.

Për sa më sipër dokumentacioni I paraqitur nga shoqëria "LIQENI VII" shpk lidhur me mjetet e mësipërme është I paplotë

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

#### 4. Operatori ekonomik "FLONJA" shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

***Në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti***

**Teknik në pikën 11 citohet si më poshtë:**

11. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 8).

Mjetet	Sasia	Gjendja
<b>Kamiona veteshkarkues (kapaciteti total mbajtës minimumi 10 ton pra 5 ton secili)</b>	<b>Minimumi 2 copë</b>	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamioncine	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Skeleri	50 m <sup>2</sup>	Pronësi ose me qera
<b>Autovinç me kosh</b>	<b>1 copë</b>	<b>Pronësi ose me qera</b>
vinç	1 copë	Pronësi ose me qera
Pompë betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Moto gjenerator	1 copë	Pronësi ose me qera
<b>Fadromë</b>	<b>1 copë</b>	<b>Pronësi ose me qera</b>
Betoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Pompë suvatimi	1 copë	Pronësi ose me qera

- a) **Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të jera duhet të jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.**
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- d) **Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.**
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- f) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi).
- g) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes

Operatori ekonomik "Flonja" shpk ka deklaruar në shtojcën 8 fadromë copë një dhe autovinç me kosh copë 1, me faturë përkatëse. Për të dy mjetet e mësipërme shoqëria nuk ka paraqitur dokumentacionin shoqëruar (targat e mjeteve, lejë qarkullim, certifikata e

kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit) C'ka bie në kundërshtim me "Kriteret e veçanta për kualifikim", kapaciteti Teknik pika 11, gërma (a) si dhe për fadromën nuk ka paraqitur as foto siç kërkohet në pikën 11 të dokumentave të tenderit gërma d ku citohet:

**Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (lejë qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi**

**Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.**

Gjithashtu shoqëria ka deklaruar në shtojcën 8 dy kamiona vetëshkarkues me kontratë qeraje nr.1254 rep dhe dhe nr.472 kolpër të cilat si afat përfundimtar të qerasë kanë datën 26.04.2016 cka bie në kundërshtim me pikën 11/c ku citohet:

**c)Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.**

Më datën 12.12.2016 është bërë hapje shpallje e procedurës së mësipërme pra për sa më sipër dokumentacioni i shoqërisë për dy kamionat vetëshkarkues është i paplotë pasi afati i kontratës është i pavlefshëm për procedurën më sipër.

**Për sa më sipër dokumentacioni I paraqitur nga shoqëria "FLONJA" shpk lidhur me mjetet e mësipërme është I paplotë**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

## **5. Operatori ekonomik "BOSHNJAKU-B" shpk**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

**Në dokumentat standartë të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik në pikën 11 citohet si më poshtë:**

**11.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 8).**

Mjetet	Sasia	Gjendja
--------	-------	---------



<i>Kamiona veteshkarkues (kapaciteti total mbajtës minimumi 10 ton pra 5 ton secili)</i>	<b>Minimumi 2 copë</b>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Eskavator me goma</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autobetoniere</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kamioncine</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<b>Autobot uji</b>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Skeleri</i>	<i>50 m<sup>2</sup></i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autovinç me kosh</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>vinç</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Pompë betoni</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<b>Moto gjenerator</b>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Fadromë</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Betoniere</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Pompë suvatimi</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
- b) *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- c) *Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata perkatese noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- d) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- e) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- f) *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).*
- g) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*

*Operatori ekonomik “BOSHNJAKU-B” shpk ka deklaruar në shtojcën 8 dy autobotë uji perkatesisht*

*Autobot uji me targë AA 365 IB për të cilin nuk ka paraqitur policën e sigurimit dhe nuk ka certifikatë të kontrollit teknik si dhe*

*Autobot uji me targë SK1720A polica e sigurimit e të cilit ka skaduar më datën 30.11.2016*

*C’ka bie në kundërshtim me “Kriteret e veçanta për kualifikim”, kapaciteti Teknik pika 11,*

gërma (a) ku citohet:

**Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (lejë qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi**  
**Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.**

Gjithashtu shoqëria nuk ka deklaruar në shtojcën 8 **motogjenerator** cka bie në kundërshtim me pikën 11 ku citohet:

***Për sa më sipër dokumentacioni I paraqitur nga shoqëria “BOSHNJAKU-B” shpk lidhur me mjetet e mësipërme është I paplotë***

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

## **6. Operatori ekonomik “ELIRA” shpk**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

***Në dokumentat standartë të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik në pikën 11 citohet si më poshtë:***

*11.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 8).*

Mjetet	Sasia	Gjendja
<b>Kamiona veteshkarkues (kapaciteti total mbajtës minimumi 10 ton pra 5 ton secili)</b>	<b>Minimumi 2 copë</b>	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
<b>Kamioncine</b>	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Skeleri	50 m <sup>2</sup>	Pronësi ose me qera
Autovinç me kosh	1 copë	Pronësi ose me qera

vinç	1 copë	Pronësi ose me qera
Pompë betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Moto gjenerator	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadromë	1 copë	Pronësi ose me qera
Betoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Pompë suvatimi	1 copë	Pronësi ose me qera

- a) **Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet të shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te jera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.**
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- d) **Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.**
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- f) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi)
- g) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet të shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

Operatori ekonomik "ELIRA" shpk ka deklaruar në shtojcën 8 dy tre kamiona përkatësisht kamion me targë TR2656F, TR9380J dhe kamionin me targë AA392 KV për kamionin me targa AA 392 KV shoqëria nuk ka paraqitur foto sic edhe kërkohet në "Kriteret e veçanta për kualifikim", kapaciteti Teknik 11/d:

**d)Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.**

**Gjithashtu shoqëria ELIRA në shtojcën 8 nuk ka paraqitur kamionçinë sic edhe kërkohet në pikën 11 "Kriteret e veçanta për kualifikim", kapaciteti Teknik të dokumentave standarte të tenderit.**

**Për sa më sipër dokumentacioni I paraqitur nga shoqëria "ELIRA" shpk lidhur me mjetet e mësipërme(fadromë) është I paplotë**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Janë kualifikuar si oferta të suksesshme, këta ofertues :

## **1. Operatori ekonomik “SAG” shpk, kualifikohet në vend të parë**

Çmimi total i ofertës pa TVSH = **6.233.472** (gjashtëmilion e dyqind e tridhjetë e tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy) leke. Çmimi total i ofertës me TVSH = **7.480.166** (shtatë milion e katërqind e tetëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë. Afati kohor për kryerjen e punimeve është brenda 5 (pesë) muajve kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

## **2. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “AVDULI” shpk, kualifikohet në vend të dytë**

Çmimi total i ofertës pa TVSH = **7.174.519** (shtatë milion e njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e pesëqind e nëntëmbëdhjetë ) **lekë**. Çmimi total i ofertës me TVSH = **8.609.423** (tetë milion e gjashtëqind e nëntë mijë e katërqind e njëzet e tre) lekë. Afati kohor për kryerjen e punimeve është brenda 5 (pesë) muajve kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, është paraqitur Formulari i Ankesës nga Operatori ekonomik “S.AG” shpk, hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën Nr. 39669 Prot. datë 23.12.2016 (administruar në dosjen e prokurimit) në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit me objekt: **“Ndërtim i ambjenteve sportive në shkollën e mesme Verri”**.

Me marjen e ankesës nga Operatori ekonomik i mësipërm në mbështetje të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 63, pika 3 si dhe në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me Urdhërin me Nr. 33957/3 Prot. dt. 23.12.2016 është pezulluar procedura e prokurimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas rregullave të parashikuara nga LPP dhe RRPP. Gjithashtu në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 6, gërma ”a” të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me Urdhërin me Nr. 33957/4 Prot. datë 23.12.2016 u ngrit Grupi i Shqyrtimit të Ankesave, i cili pasi u njoh me pretendimet e Shoqërisë “S.AG” shpk konkludoi në pranimin e ankesës, duke i kthyer pergjigje me shkresën me Nr. 33957/6 Prot. datë 27.12.2016.

Për sa më sipër në kuadër të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, me shkresën nr.33957/6 datë 27.12.2016, riklasifikimi dhe renditja përfundimtare është si më poshtë vijon:

### **Operatori ekonomik “S.AG ” shpk kualifikohet në vend të parë.**

Çmimi total i ofertës pa TVSH = **6.233.472** (gjashtëmilion e dyqind e tridhjetë e tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy) leke. Çmimi total i ofertës me TVSH = **7.480.166** (shtatë milion e katërqind e tetëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë. Afati kohor për kryerjen e punimeve është brenda 5 (pesë) muajve kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës



## **Operatori ekonomik “AVDULI” shpk kualifikohet në vend të dytë.**

Çmimi total i ofertës pa TVSH = **7.174.519** (shtatë milion e njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e pesëqind e nëntëmbëdhjetë ) **lekë**. Çmimi total i ofertës me TVSH = **8.609.423** (tetë milion e gjashtëqind e nëntë mijë e katërqind e njëzetë e tre) lekë. Afati kohor për kryerjen e punimeve është brenda 5 (pesë) muajve kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Shoqërinë “SAG” shpk me adresë:** Adresa: Rruga: Asim Zeneli, Pallati SAG, Kati II, Tiranë se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme pa TVSH, **6.233.472** (gjashtëmilion e dyqind e tridhjetë e tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy) leke **është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, 1001, Tiranë, Sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit, është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme pa TVSH, **7.174.519** (shtatë milion e njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e pesëqind e nëntëmbëdhjetë ) **lekë**, siç parashikohet në nenin 58 të ligjit për prokurimet publike nr.9643 date 20.11.2006

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 06.01.2017

Ankesa:Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur ankesë.